



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 456/2 prot.

Tiranë, më 05.03.2026

VENDIM

Nr. 09, datë 05.03.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularët e ankesave me nr. 2780 Prot., nr. 2781 Prot., datë 28.10.2025 dhe nr. 3162 Prot., datë 10.12.2025 me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Universiteti i Tiranës (në vijim “Autoriteti Publik”).

Duke qenë se, ankesat i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesi, me anë të kërkesës së parë për informacion datë 15.10.2025, depozituar në adresën elektronike franceska.celmeta@unitir.edu.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Fazën aktuale të shqyrtimit të kallëzimit tim;
2. Nëse është ngritur Këshilli i Etikës për verifikimin apo vlerësimin e këtyre çështjeve;
3. Afatet e parashikuara për përfundimin e procesit dhe njoftimin e palëve;
4. Regjistrimin zyrtar të kërkesës në Programin e Transparencës të faqes zyrtare të Universitetit të Tiranës.

Me anë të kërkesës së dytë për informacion datë 15.10.2025, ankuesi ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Një kopje të shkresave të protokolluara në fillim të vitit akademik, të ndarjes së stafit akademik të departamentit Ekonomiksi, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në personel me orientim kërkimor-shkencor, për vitin akademik 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026.*
2. *Pedagogët e departamentit që janë angazhuar në hartim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare dhe implementime të projekteve si COST, JeanMonnet, Erasmus + KA2, Horizon. Interreg, AKKSHI, UT-KEI, etj për vitin 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026, të shoqëruar me emrin përkatës të këtyre projekteve.*
3. *Një kopje të shkresës zyrtare të ngarkesës mësimore të personelit akademik të departamentit të ekonomksit, për 3 vitet e fundit akademike 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026.*

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës së tretë për informacion të datës 29.10.2025, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Shpërndarja e fondit të pagave për Universitetin e Tiranës për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025), e ndarë sipas: njësisive bazë (fakultete dhe departamente), kategorive të stafit (akademik, ndihmës akademik)*
2. *Fondi i akorduar për pagesat e mbingarkesave (orë shtesë) për të gjithë Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, për vitet buxhetore 2023, 2024, 2025 dhe planin 2026, si dhe realizimi faktik në buxhet i kësaj transferte të kushtëzuar për secilin vit.*
3. *Lista e projekteve kërkimore të financuara nga buxheti i shtetit dhe nga vetëfinancimet e UT (pra vetëm projektet me financim nga buxheti shtetit/AKSHI dhe fondet e UT) përfshirë: titullin e projektit, drejtuesin dhe grupin e punës, njësinë përkatëse, buxhetin e miratuar dhe raportin e realizimit për secilin vit (2023, 2024-2025).*
4. *Kriteret dhe procedurat e përdorura për caktimin e ngarkesës mësimore për personelin akademik në nivel departamenti dhe fakulteti, konkretisht departamenti i ekonomksit, Fakulteti i Ekonomisë, për vitet akademike 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026.*
5. *Shpenzimet e realizuara për konferenca, ëorkshop-e, dhe mobilitete akademike/shkencore (brenda dhe jashtë vendit) për 3 (tre) vitet e fundit, duke përfshirë për secilin rast: përfituesin, destinacionin, qëllimin dhe burimin e financimit.*
6. *Raportet e auditimit të brendshëm për Universitetin e Tiranës për vitet 2023 dhe 2024, si dhe masat e marra nga institucionet drejtuese pas rekomandimeve të auditit.*

Ankuesi, në mungesë të përgjigjeve të kërkesave për informacion, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për

dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas pikave secilës kërkesë për informacion datë 15.10.2025, si dhe datë 29.10.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik duke kërkuar të informohet lidhur me ankesat e bëra nga ankuesi.

Me emailin e datës 10.11.2025 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“...Dokumentacioni i kërkuar nuk administrohet nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, por nga njësia përkatëse, e cila mban përgjegjësinë për ruajtjen dhe administrimin e këtyre të dhënave. Rrjedhimisht kërkesa duhet të trajtohet fillimisht nga Fakulteti i Ekonomisë. Kërkesa duhet t’i drejtohet drejtpërdrejt nësisë përkatëse dhe jo Rektoratit. Gjithashtu ju informojmë se informacioni i kërkuar përmban edhe të dhëna të personave të tretë, të cilët gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe për rrjedhojë nuk mund të vihen në dispozicion pa respektuar parimet e këtij ligji, sanksionuar në nenin 2 të tij, citojmë: “ Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.” Në lidhje me objektin e kërkesës, vlerësohet se, kërkesa duhet të përmbajë edhe përcaktimin e qartë të qëllimit për të cilin kërkohet informacioni, pasi një qëllim i tillë nuk rezulton i evidentuar në dokumentacionin e paraqitur, bazuar në të dhënat e kërkuara që nuk mund të jepen pa miratimin e personave të tretë, që janë të përcaktuara në këto dokumente. Në mungesë të një qëllimi të përcaktuar, të dhënat e kërkuara mund të merren vetëm në kuadër të informacionit për veprimtarinë e brendshme të institucionit, ose nga organet ligj zbatuese, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore.”*

Në vijim, ankuesi nëpërmjet emailit datë 10.11.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2780/1 Prot., datë 11.11.2025, ka vijuar ankimin duke sqaruar se: *“...Kërkesat janë bërë në përputhje me nenin 3, paragrafi 1 të Ligjit nr. 119/2014, që garanton të drejtën e çdo personi për të marrë informacion mbi veprimtarinë publike të institucioneve shtetërore. Megjithatë, Rektorati, në përgjigjen e vet zyrtare, ka deklaruar se “dokumentacioni i kërkuar nuk administrohet nga Rektorati, por nga Fakulteti i Ekonomisë”, dhe se “informacioni përmban të dhëna të personave të tretë”, duke e kushtëzuar dhënien e informacionit me “miratimin e këtyre personave”. Ky qëndrim përbën refuzim të padrejtë dhe shmangie nga përgjegjësia ligjore, për arsyet në vijim: 1. Rektorati është autoriteti i lartë administrativ dhe mbikëqyrës i fakulteteve dhe ka përgjegjësi për mbledhjen, ruajtjen dhe vënien në dispozicion të informacionit publik që lidhet me veprimtarinë akademike të njësive të vartura. Duke qenë se Fakulteti i Ekonomisë është në varësinë administrative të Universitetit të Tiranës, Rektorati ka pasur detyrimin institucional të koordinojë dhe të kërkojë përgjigjen nga*

Fakulteti, në vend të refuzojë kërkesën. 2. Ngarkesa mësimore e stafit akademik nuk përbën informacion konfidencial, pasi: Orari i mësimdhënies dhe emrat e pedagogëve janë publikisht të afishuar në faqet zyrtare të fakulteteve, duke përbërë informacion tashmë të hapur për publikun; Angazhimi i personelit akademik në projekte kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare është detyrim statutor dhe ligjor për transparencë, në përputhje me parimet e “Shkencës së Hapur” dhe me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike, që kërkon publikimin e të dhënave mbi veprimtarinë kërkimore të stafit akademik. 3. Kufizimi i dhënies së informacionit me arsyetimin e “të dhënave personale” është i pabazuar dhe joproporcional, pasi informacioni i kërkuar lidhet me funksione publike dhe jo me të dhëna private të individëve. 4. Ligji nr. 119/2014, neni 17, përcakton se çdo kufizim i të drejtës për informim duhet të jetë proporcional, i arsyetuar dhe në interes publik, gjë që në këtë rast nuk është respektuar. 1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat. Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Në rastin konkret ekzistojnë dyshime mbi zbatueshmërinë e akteve lgjore dhe nënlgjore në fuqi sa i përket funksionimit të një Institucioni publik të Arsimit të Lartë. 5. Neni 9, pika 1 e ligjit thotë: Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen. Në këtë kuptim në shkresën dërguar rektoratit me datë 26.03.2025 nga një subjekt tjetër, rezulton ti jete dhënë përgjigje e plotë mbi informacionin sa i përket integritetit akademik. Gjithashtu sa i përket informacionit për ngarkesën mësimore i është dhënë informacioni i plotë nga ana e rektoratit shkresës me Nr.prot 2980/2 i datës 01.11.2022. <https://unitir.edu.al/arkiva-regjistri-i-kerkesave-2022/>. Po ashtu, sa i përket projekteve ndërkombëtare është dhënë informacion i plotë nga Rektorati në shkresën e datës 26.03.2024. 6. Qëllimi i kërkesës është verifikimi i zbatimit të ligjit dhe rregullave të etikës akademike - pra, një qëllim legjitim publik.”

Pas vijimit të ankimit, Zyra e Komisionerit me emailin datë 25.11.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar lidhur me pretendimet e ankuesit, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion brenda datës 03.12.2025.

Autoriteti Publik, me emailin datë 03.12.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...Kërkesa për informacion në të cilën kërkohet informacion mbi kallëzimet zyrtare që ka paraqitur kërkuesi z. pranë Rektoratit më date 30.09.2025, lidhur me dyshimet për raste plagjiature në punimet e z. Ledjon Shahini dhe mos reagimi për çështjen e doktoratës me nr. Prot 2922, 2922/1 dhe 2922/2, janë kërkesa thellësisht personale, të cilat trajtohen në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në

Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të miratuara në zbatim të tij. Në përgjigjen e dhënë nga Universiteti i Tiranës, kërkuesi është informuar se kërkesa duhej të adresohet pranë Fakultetit të Ekonomisë, në të cilin z. ka zgjedhur të ndjekë studimet e Ciklit të Tretë të studimeve “ Doktoratë”. Informacioni i kërkuar nuk ka asnjë lidhje me informacionin publik në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, madje edhe vetë z. në ankesën e tij ka pranuar se kërkesat për informacion mbi hetimin e kallëzimeve të mia për rastet e dyshuara të plagjiaturës në Fakultetin e Ekonomisë, përbëjnë çështje në kompetence të Rektoratit sipas rregulloreve të brendshme dhe Kodit të Etikës së Universitetit të Tiranës. Për sa kohë që z. është duke ndjekur studimet në Universitetin e Tiranës, kërkesat që kanë lidhje me zhvillimin e projektit të tij kërkimor apo pretendimet mbi shkelje të etikës në kërkimin shkencor nga personeli akademik i Universitetit të Tiranës do të trajtohen në mënyrë institucionale , në përputhje me rregullat e zbatueshme në Universitetin e Tiranës, duke theksuar se trajtimi i kallëzimeve të tij për shkak të natyrës thellësisht akademike nuk mund të shqyrtohet brenda afateve që përcaktohen, në dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “ Për të Drejtën e Informimit” dhe kërkon kohën e nevojshme për trajtimin e saj.

Në lidhje me kërkesën tjetër për informacion, në të cilën kërkohen të dhëna për Departamentin e Ekonomiks, pranë Fakultetit të Ekonomisë ku z. kryen studimet “Doktoratë” , kjo kërkesë duhet të adresohet për trajtim nga Fakulteti i Ekonomisë, fakt për të cilin ai është informuar. Argumenti i sipërcituar mbështetet në pikën 4, të nenit 12, të Statutit të Universitetit të Tiranës, parashikohet se “ 4. Fakulteti ka personalitetin e tij juridik, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky Statut. Drejtuesi i fakultetit është dekani. Dekani është autoriteti më i lartë i fakultetit dhe përfaqësuesi i tij. Ai koordinon veprimtarinë e njësisve bazë dhe të organeve kolegjiale të fakultetit dhe zgjidh mosmarrëveshjet midis tyre.”.

Sa më sipër, Universiteti i Tiranës ri konfirmon qëndrimin e tij se përgjigjet e dhëna në drejtim të z. nuk duhet të konsiderohen si refuzim i pa drejtë i së drejtës për informim por si përgjigje që kanë orientuar kërkuesin në drejtim të zbatimit të ligjit nr. 80/2015, i cili në themel të tij ka garantimin e autonomisë dhe lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, në të gjitha format e tyre të përcaktuara nga ligji.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar ankimin e regjistruar me nr. 2780/3 Prot., datë 10.12.2025 duke i kërkuar Komisionerit ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Ndërkohë, lidhur me ankesën e tretë, pas kontaktit me Autoritetin Publik, ky i fundit ka kthyer përgjigje me emailin datë 20.02.2026 duke sqaruar se: “-Shpërndarja e fondit të pagave për Universitetin e Tiranës për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025), e ndarë sipas:· njësisve bazë (fakultete dhe departamente), bashkëlidhur në format tabelle;· kategorive të stafit (akademik, ndihmës akademik).Sqarojmë se me Vendimin nr.16, datë 12.05.2023, të Bordit të Administrimit të UT-së “Për miratimin e pagave të stafit akademik” sipas Vendimit nr. 748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar,

UT, ka miratuar kufirin maksimal të pagave të personelit akademik me kohë të plotë të UT-së, sipas lidhjes nr. 1 “Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, të VKM-së nr. 243, datë 20.04.2023”. Bashkëngjitur gjeni lidhjen nr. 1 të VKM-së nr. 243, datë 20.04.2023. Bashkëngjitur gjeni Vendimin nr. 40 të Bordit të Administrimit.

- Fondi i akorduar për pagesat e mbingarkesave (orë shtesë) për të gjithë Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, për vitet buxhetore 2023, 2024, 2025 dhe planin 2026, si dhe realizimi faktik në buxhet i kësaj transferte të kushtëzuar për secilin vit.

Lidhur me informacionin e kërkuar bashkëngjitur gjen Udhëzimin NR. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.

- Kriteret dhe procedurat e përdorura për caktimin e ngarkesës mësimore për personelin akademik në nivel departamenti dhe fakulteti, konkretisht, departamenti i ekonomiksit, Fakulteti i Ekonomisë, për vitet akademike 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026. (Pra, të kuptohet nëse ndarja e ngarkesës është: preferenciale-kush dëshiron merr, apo e rregulluar mbi bazën e disa kriterëve, qofshin ato në nivel njësie kryesore apo bazë). Ju informojmë se kriteret dhe procedurat për caktimin e ngarkesës mësimore realizohen bazuar në udhëzimin nr. 29 të Ministrisë së Arsimit.

- Shpenzimet e realizuara për konferenca, ëorkshop-e, dhe mobilitete akademike/shkencore (brenda dhe jashtë vendit) për 3 (tre) vitet e fundit, duke përfshirë për secilin rast: përfituesin, destinacionin, qëllimin dhe burimin e financimit.

Ju sqarojmë se në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës gjendet informacioni i publikuar për çdo konferencë dhe ëorkshop të realizuar nga UT. Në librin e punimeve të konferencave do të gjeni informacionin e detajuar.”

Me emailin e datës 29.01.2026 Autoriteti Publik ka vijuar me përgjigjen duke sqaruar se: *Lidhur me kërkesën tuaj, “ Lista e projekteve kërkimore të financuara nga buxheti i shtetit dhe nga vetëfinancimet e UT (pra vetëm projektet me financim nga buxheti i shtetit/AKKSHI dhe fondet e UT), përfshirë: titullin e projektit, drejtuesin dhe grupin e punës, njësinë përkatëse, buxhetin e miratuar dhe raportin e realizimit për secilin vit (2023, 2024, 2025) ju informojmë se të dhënat lidhur me kërkesën e sipërcituar gjenden në linket si më poshtë: <https://unitir.edu.al/projekte-qe-zbatohen-ne-ut/> dhe <https://nasri.gov.al/dokumente/>, në të cilat jepen të dhëna mbi projektet që financohen nga AKKSHI dhe fondet e UT.”*

Pas përgjigjeve të sipërcituara, me pretendimin se informacioni është në përputhje me kërkesat për informacion, me emailin e regjistruar me nr. 456 Prot., datë 10.02.2026, ankuesi ka vijuar sërish ankimin. Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 18.02.2026 me praninë e palëve.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e tij, ndërkohë përfaqësuesit e Autoritetit Publik mbas sqarimeve të dhëna kërkuar gjithashtu kohë për të rivlerësuar qëndrimin e tyre.

Në vijim të seancës, nëpërmjet emailit të datës 20.02.2026, Autoriteti Publik ka dërguar qëndrimin përfundimtar lidhur me pretendimet e ankuesit duke sqaruar ndër të tjera se: *“Në lidhje me informacionin e kërkuar më datë 15.10.2025, a) për sa i përket pikës së parë të kësaj kërkesë, po ju informojmë se, nga të dhënat e administruara nga Universiteti i Tiranës, për Fakultetin e Ekonomisë, Departamenti i Ekonomiksit ka në përbërjen e tij 5 anëtarë të personelit akademik me titullin akademik “Profesor”, 12 me titullin “Profesor i Asociuar”, 9 anëtarë me gradën shkencore “Doktor” dhe 7 me “Master Shkencor”. Kjo ndarje, është realizuar në përputhje të plotë me nenet 57 dhe 64, të ligjit nr. 80/2015. Megjithatë për informacione shtesë, ankuesi mund t’i drejtohet Fakultetit të Ekonomisë, i cili në zbatim të pikës 4, të nenit 12 të Statutit të UT-së, ka personalitetin e tij juridik, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe Statuti. Ndërkohë që, Drejtuesi i fakultetit është dekani që, është autoriteti më i lartë akademik i fakultetit dhe përfaqësuesi i tij dhe ka përgjegjësi për koordinimin e veprimtarisë së njësive bazë dhe të organeve kolegjiale të fakultetit, si dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre. b) në lidhje me pikën e tretë të kësaj kërkesë, pas sqarimeve të ankuesit, për informacionin e kërkuar mbi ngarkesën mësimore, e cila duhet theksuar se, nuk ka asnjë lidhje me programin e tij të studimit, vlerësojmë se, nga ana e Zyrës së Komisionerit, duhet të merret në konsideratë pohimi i tij në Relacionin për Seancën Dëgjimore, ku pranohet se, “...Orari i mësimdhënies dhe emrat e pedagogëve janë publikisht të afishuar në faqet zyrtare të fakulteteve, duke përbërë informacion tashmë të hapur për publikun ...”. Informacioni publik i sipërcituar, mundëson përlllogaritjen e ngarkesës mësimore, megjithatë për informacion shtesë, ankuesi mund t’i drejtohet Fakultetit të Ekonomisë, referuar në nenin 12, nenin 47, pika 1, germa “gj” dhe 51, pika 1, germa “b”, të Statutit të UT-së, për shkak se, mbikqyrja e shpërndarjes së ngarkesës mësimore është përgjegjësi e njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Në lidhje me pikën e dytë të kësaj kërkesë, është vlerësuar që të përcillet lista e projekteve 2023-2025, ku nuk përfshihen të dhënat për projekte që janë individuale si COST, por që janë listuar në kërkesën për informacion të ankuesit. Në lidhje me kërkesën e përsëritur për dhënien e informacioni, mbi listën e projekteve kërkimore, ju informojmë si më poshtë vijon: Programet kryesore nga të cilat është mbështetur Universiteti i Tiranës në kuadër të kërkimit shkencor dhe inovacionit përmes projekteve të implementuara për vitet 2023-2025 janë në linket si më poshtë:*

<https://unitir.edu.al/tabele-pasqyre-mbi-projektet-aktive-ne-ut/>

<https://unitir.edu.al/programi-erasmus/>

<https://unitir.edu.al/programet-horizon/>

<https://unitir.edu.al/program-akkshi/>

<https://unitir.edu.al/program-jean-monnet/>

<https://unitir.edu.al/program-interreg/>

<https://unitir.edu.al/unicef/>

<https://unitir.edu.al/program-europe-for-citizens/>

<https://unitir.edu.al/program-justice/>

<https://unitir.edu.al/program-auf/>

<https://unitir.edu.al/heras/>

Së dyti, Në lidhje me informacionin e kërkuar më datë 29.10.2025, vlerësojmë se, informacioni i dhënë është i plotë, megjithatë në mënyrë të zgjeruar po ju përcjellim edhe një informacion që lidhet me të dhënat financiare dhe buxhetore, të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Ekonomisë, si dhe informacionin në lidhje me shpenzimet e realizuara nga Fakulteti i Ekonomisë për konferenca, mobilitetet akademike/shkencore, etj.

Ankuesi ka kërkuar edhe raportet e auditimit të brendshëm për vitet 2023 dhe 2024. Në lidhje me këtë kërkesë, fillimisht sqarojmë se, as në ligj dhe as në statut, nuk parashikohet kjo e drejtë për të gjithë studentët që kanë zgjedhur të kryejnë studimet pranë Universitetit të Tiranës. Universiteti i Tiranës zbaton me përpikmëri nenin 116, të ligjin nr. 80/2015 që mundëson auditimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional nga organet kompetente për këtë qëllim.

Në këtë pikë theksojmë se, çdo njësi audituese ka detyrimin ligjor të konfidencialitetit të të dhënave, që lidhen me procedurën e auditimit, të parashikuar në germën “d” të nenit 16, të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Për sa kohë që, ky kufizim në lidhje me aksesin në të dhënat e auditit lidhet me audituesit e brendshëm, ky lloj informacioni është i kufizuar, edhe për publikun, duke përjashtuar autoritetet apo organet e institucioneve të përfshira, ministrinë e arsimit për shkak të përgjegjësisë shtetërore, apo Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me nenin 25, të ligjit nr. 114/2015, i ndryshuar.

Ky informacion përbën edhe qëndrimin e Universitetit të Tiranës, në lidhjen me ankesat e studentit të programit “Doktorat”, Z. drejtuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale...”.

Me emailin e datës 20.02.2026, ankuesi ka paraqitur argumentet e tij lidhur me përgjigjen e sipërcituar, duke sqaruar se: “Universiteti ka pretenduar se informacioni mbi ngarkesën mësimore mund të përlllogaritet nga të dhëna të publikuara në faqet zyrtare. Ky argument nuk qëndron. Të dhënat e publikuara nuk janë të plota dhe nuk përbëjnë dokument administrativ të konsoliduar mbi ngarkesën reale mësimore të personelit akademik. Për më tepër, nuk është detyrë e kërkuarit të rindërtojë informacionin nga burime të fragmentarizuara apo të bëjë përlllogaritje individuale. Ligji për të drejtën e informimit detyron autoritetin publik të vërë në dispozicion informacionin që ai vetë administron në formën e dokumentit zyrtar. Vetë Universiteti pranon se organizimi i ngarkesës akademike dhe fondi i pagave administrohen në nivel institucional nga Rektorati, çka konfirmon se informacioni ekziston dhe nuk është konfidencial. Po ashtu, pretendimi se informacioni duhet kërkuar pranë Fakultetit të Ekonomisë përbën shmangie të përgjegjësisë institucionale. Në praktikën administrative të Universitetit të Tiranës, të gjitha kërkesat për informacion për fakultetet trajtohen nga vetë universiteti si autoritet publik. Në komunikimet me Universitetin e Tiranës është pranuar se kërkesat janë përcjellë nga Rektorati drejt Fakultetit të Ekonomisë, por nuk është marrë përgjigje nga kjo strukturë. Nëse Fakulteti nuk i përgjigjet Rektoratit, është proceduralisht e pajustifikueshme që kërkuari të orientohet drejt të njëjtës

strukturë. Rektorati është autoriteti më i lartë administrativ i universitetit dhe mban përgjegjësi për koordinimin e strukturave përbërëse. Organizimi i brendshëm nuk mund të përdoret si mekanizëm për të kufizuar të drejtën për informim. Neni 33 pika 1 e Statutit të Universitetit të Tiranës thotë Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Rregulloret e brendshme të një institucioni publik nuk mund të vendosen mbi aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe nuk mund të përdoren si bazë për të kufizuar një të drejtë themelore të garantuar me ligj. Po ashtu, argumenti i përdorur nga Universiteti se kërkuesi është student doktore dhe se informacioni mbi ngarkesën mësimore nuk lidhet me programin e studimit është juridikisht i pabazuar.

Ligji për të drejtën e informimit nuk kushtëzon aksesin në informacion nga statusi, pozicioni apo interesi personal i kërkuesit. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik pa qenë i detyruar të justifikojë interesin e tij.

Sa i përket përgjigjes së autoritetit për projektet kërkimore është dërguar sërish e njëjta praktike, vetëm linqe, dhe asgjë nga ato që unë ka kërkuar. AKKSHI publikon emrin dhe mbiemrin e përfituesve të projekteve shkencore financuar nga buxheti i shtetit. Informacioni që unë kërkoj është tërësisht legjitim, në përputhje me cdo akt ligjor dhe nënligjor në fuqi, dhe që është i disponueshëm, pasi cdo departament, pasi fiton një projekt ngre grupin e punës, dhe grupi i punës duhet të ngrihet me shkresë zyrtare, në të kundërt kemi të bëjmë me shkelje të ligjit. Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Udhëzimi Nr.29 i Ministrisë dhe Statuti i Universitetit të Tiranës sanksionojnë ndarjen e stafit akademik në mësimor dhe kërkimor në nivel departamenti.

Asnjë përgjigje për shpenzimet për konferenca dhe mobilitete akademike duke shmangur dhënien e informacionit financiar mbi përfituesit, destinacionin, qëllimin dhe burimin e financimit. Publikimi i një konference nuk është e barabartë me publikimin e shpenzimit buxhetor për atë aktivitet. Transparenca financiare kërkon të dhëna mbi përdorimin e fondeve publike, jo vetëm njoftime akademike.

Sa i përket raporteve të auditimit, ripërsëris dhe njëherë Ligji nr. 119/2014, neni 3 dhe 7, Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik. Autoriteti publik ka detyrimin ta japë atë. Raporti vjetor i auditimit të brendshëm është dokument i prodhuar nga autoritet publik në ushtrim të funksioneve të tij dhe për rrjedhojë përbën “informacion publik” në kuptim të nenit 3 të ligjit. Ligji nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm nuk parashikon klasifikim automatik apo sekretim të raporteve vjetore të auditimit. Nëse institucioni ka pretenduar se raporti përmban të dhëna sensitive atëherë autoriteti ka detyrimin ligjor të aplikojë parimin e proporcionalitetit dhe të bëjë anonimizimin e pjesëve sensitive, jo refuzim total të dokumentit. Raportet e auditimit të brendshëm lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e fondeve publike, integritetin administrativ dhe transparencën institucionale, çka përbën interes të lartë publik. Prandaj, konkludoj se: Refuzimi i dhënies së raportit vjetor të auditimit të brendshëm nuk mbështetet në asnjë përjashtim të shprehur ligjor, bie ndesh me parimin e transparencës administrative dhe përbën kufizim disproporcional të së drejtës për informim. Edhe në rastin e ekzistencës së të dhënave të mbrojtura, autoriteti kishte detyrimin të aplikonte anonimizimin e pjesshëm dhe jo refuzimin total të informacionit.

Ky model përgjigjesh tregon një qasje selektive ndaj transparencës: jepet informacion kur është i përgjithshëm ose tashmë publik, ndërsa shmanget dhënia e informacionit konkret financiar dhe administrativ që lejon verifikim real të llogaridhënies. Kjo bie ndesh me frymën e Ligjit nr. 119/2014, i cili synon jo vetëm informim formal, por akses real dhe efektiv në dokumente, për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara për ankesat objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me dispozitat e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Universiteti i Tiranës është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Komisioneri, vlerëson gjithashtu se, një pjesë e dokumentacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë, bazuar kjo, në shkronjat “dh” dhe “e” të pikës 1 të nenit 7 të LDI, në të cilat parashikohet se: *“1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit; e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;*

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në

mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik jo në përputhje me LDI.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni objekt shqyrtimi, përbën informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendoset në dispozicion të ankuesit në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas pikës 6 të nenit 17 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Ndërkohë, pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave të z. me nr. 2780 Prot., nr. 2781 Prot., datë 28.10.2025 dhe nr. 3162 Prot., datë 10.12.2025, ndaj Autoritetit Publik, Universiteti i Tiranës me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit sipas kërkesave për informacion datë 15.10.2025 dhe 29.10.2025, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 17.03.2026.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 05.03.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi